

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme me të cilën kryesonte kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, të mbajtur më 25.04.2024, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 nga Ligji për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), neni 63 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi kërkesën – iniciativën për miratimin e mendimit juridik parimor të paraqitur nga Illko Petrov nga Shkupi, të evidentuar nën Su03 nr.177/24 të datës 05.03.2024, nxori këtë:

## KONKLuzion

**Kërkesa për mendimin juridik parimor, e paraqitur nga Illko Petrov nga Shkupi, evidentuar nën SU-03.nr.177/24 të datës 05.03.2024, HIDHET POSHTË.**

### A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 nga Ligji për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.58/06 . . .96/19), Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 25.04.2024, shqyrtoi mbi kërkesën – iniciativën e Illko Petrov nga Shkupi, të evidentuar nën SU-03.nr.177/24 të datës 05.03.2024, për miratim të mendimit juridik parimor.

Në kërkesën e paraqitësit sipas të dhënave propozohet që të harmonizohet praktika gjyqësore lidhur me zbatimin e nenit 180 të LPP.

Paraqitësi thekson se në Gjykatën Themelore Civile Shkup ka pasur një kontest 39 P4-344/22 në mes Illko Petrov si paditës dhe RMV si e paditur, për kompensim të dëmit. Gjatë procedurës paditësi Illko Petrov e ka ndryshuar padinë, por Gjykata Themelore Civile Shkup me aktvendim 39 P4-344/22 të datës 25.10.2022 nuk e ka lejuar ndryshimin, me arsyetim se me ndryshimin procedura do të zvarritet pa nevojë dhe është në kundërshtim me ekonomizimin e procedurës. Për këtë aktvendim paditësi ka deklaruar ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit Shkup me aktvendim GZH-3948/22 të datës 03.11.2023 ankesën e refuzon dhe e konfirmon aktvendimin e Gjykatës Themelore Civile Shkup 39 P4-344/22 të datës 25.10.2022.

Përveç kësaj thuhet se praktika gjyqësore në vendet fqinje – në Serbi është e ndryshme nga e jona, sepse aktvendimi i Gjykatës së Apelit Shkup GZH-3948/22 të datës 03.11.2023 është në kundërshtim me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Beograd nga viti 1986. Nëse ka pasur mendim juridik për nenin 180 të LPP, nuk do të ankohej dhe të humbas një vit të tërë që të zgjidhet problemi se a do ta pranojë gjykata apo jo këtë kërkesë timen për ndryshimin e padisë.

Në nenin 37 paragrafi (1) nga Ligji për gjykatat, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e përgjithshme: - miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore mbi çështje të rëndësishme duke ofruar barazi në zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej 3 muajsh, dhe jo më shumë se 6 muaj me vetiniciativë, apo me iniciativë të kryetarit të gjykatës, apo me iniciativë të seancave të gjyqtarëve apo sektorëve të gjykatave, apo me iniciativë të avokatëve dhe i publikon në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Seanca e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut duke vendosur mbi kërkesën – iniciativën konstatoi se e njëjta është paraqitur nga një person fizik, dhe jo nga një subjekt i autorizuar, sipas dispozitës të sipërcituar.

Duke marrë parasysh të ekspozuarën, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nxori konkluzion që kërkesa Su-03 nr.177/24 të datës 05.03.2024 të hidhet poshtë, për arsye se nuk është paraqitur nga një subjekt i autorizuar, sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 nga Ligji për gjykatat.

**SEANCA E PËRGJITHSHME E GJYKATËS SUPREME  
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**